



ARGUMENTUM

news opinion analysis



NËNTORI I LIRISË SHQIPËRIA FESTON 111-VJETORIN E PAVARËSISË!

Samiti i III-të i Diasporës
bën bashkë në Tiranë
shqiptarët e të gjithë trevave

Cili është plani
i NATO-s
për Ballkanin?

Udhëheqësit arabë bëjnë
thirrje për përfundimin e
menjëhershëm të luftës në Gaza

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 JO VETEM LAJM

- NËNTORI I LIRISË

- 111-VJETORI I PAVARËSISË,
CEREMONIA E NGRITJES SË FLAMURIT NË VLORË

- Antony Blinken uron Shqipërinë për 111-vjetorin e Pavarësisë:
SHBA krenare që punon me ju si aleate dhe partnere të NATO-s

06 POLITIKË | SHQIPËRI

- Hamasi nis sulm të befasisëm/ Kryeministri Netanyahu thotë se Izraeli “në luftë”

9 FOKUS

- CILI ËSHTË PLANI I NATO-S PËR BALLKANIN?
- Vlerësime e kritika për Samitin III të Diasporës!

12 RAJON

- PANAIRI I VERËS TË “OPEN BALKAN”/ Vuçiç zëvendëson Kryeministrin Rama

- KE prezanton një plan të ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor,
duke përfshirë 6 miliardë euro grante dhe kredi

- Kosovë-Shqipëri-Maqedoni e Veriut, Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim drejt integritimit evropian

15 BOTA

- Udhëheqësit arabë dhe myslimanë bëjnë thirrje për përfundimin

e menjëhershëm të luftës në Gaza

- Papa Françesku: “Bota është në luftë, dhe industria e armëve qëndron pas saj.”

ENGLISH EDITION

21 ENGLISH TOP NEWS

- Parade of Albanians in Tirana, national flag hoisted at “Skanderbeg” square

- Participant in the 3rd summit of Diaspora shared the same opinion: Albanian factor has never been in better positions than today

23 CURRENT EVENTS

- Rama says Greece can block the EU’s integration of Albania, but the Beleri case “is an issue that is minor even from a bilateral point of view”

24 BALKAN OVERVIEW

- Secretary General in Pristina: “NATO will do what is necessary to maintain a safe and secure environment in Kosovo”

- EC publishes Albania’s progress report highlighting progress and problems

26 IN FOCUS

- The eighth round of the School for European Integration ends

28 REALPOLITIK

- The wrong kiss! Problematic progress! Little benefit, much harm! No Parisian Davos!

31 GLOBAL

- Former US Secretary of State Henry Kissinger dies aged 100

NËNTORI I LIRISË



Ndër shekuj, Nëntori ka shënuar ngjarjet më të rëndësishme të popullit tonë. Më 28 nëntor të vitit 1443, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, ngriti flamurin në Krujë. “Lirinë nuk jua solla unë po e gjeta këtu në mes tuaj”, citohet të ketë thënë Zoti i Arbërisë, heroi ynë kombëtar, duke iu drejtuar turmës entuziaste.

28 nëntori nuk është një përvjetor i thjeshtë. Është krentimi i idealeve dhe vlerave themelore të jetës, që përbëjnë identitetin, kulturën e udhën tonë. Është krentimi i të qenit tonë shqiptarë, pas shumë shekujsh gëzojmë e jetojmë në një shoqëri të pavarur e demokratike.

7 Kështu, më 28 Nëntor, të gjithë shqiptarët, në trojet e tyre dhe kudo jetojnë e punojnë nëpër botë, kremtojnë me krenari Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga perandoria otomane turke.

111-VJETORI I PAVARËSISË, CEREMONIA E NGRITJES SË FLAMURIT NË VLORË



Në qytetin e Vlorës, pranë monumentit të Pavarësisë, u zhvillua sot ceremonia e ngritjes së flamurit me rastin e 111- vjetorit të Pavarësisë. Në ceremoni ishin të pranishëm Presidenti Bajram Begaj, kryeministri Edi Rama, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, prefekti i qarkut të Vlorës, Flamur Mamaj, kryetari i bashkisë së Vlorës Ermal Dredha, drejtues të pushtetit vendor, qytetarë, etj.

Pas ekzekutimit të himnit kombëtar presidenti Begaj, kryeministri Rama, kryeministri Kurti dhe kryeparlamentarja Nikolla vendosën kurora me lule dhe u përkulën me respekt pranë monumentit simbol të kurorëzimit të përpjekjeve shekullore për liri e pavarësi, si homazh në këtë ditë të rëndësishme kujtese mbarëkombëtare.

Shqipëria feston sot 28 Nëntorin, 111 vjet nga shpallja e Pavarësisë. 28 Nëntori njihet ndryshe edhe si Dita e Flamurit, një ditë e rëndë-

sishme për shqiptarët në trevat shqiptare dhe anembanë botës.

Nderkohe me 29 Nëntor Begaj, Nikolla dhe Rama kryen homazhe pranë monumentit “Nënë Shqipëri”.

Presidenti Bajram Begaj, kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla dhe kryeministri Edi Rama zhvilluan sot homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

Ata vendosën kurora me lule pranë Monumentit “Nënë Shqipëri” dhe u përkulën në nderim dhe respekt të sakrificës së dëshmorëve në 79-vjetorin e Çlirimit të vendit.

Kreu i Shtetit iu përcollti shqiptarëve një mesazh për 29 Nëntorin. “Gëzuar festën e Çlirimit Shqipëri. Nderim përjetë atyre që me guximin, trimërinë dhe sakrificën e tyre sublime, na dhuruan lirinë”.

Zëvendës shefja në detyrë e Misionit të SHBA dhe Këshilltarja e Lartë për Zhvillim e USAID-it, Mischere Kawas, përfaqësoi Ambasaden e SHBA sot në një ceremoni përkujtimore në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

“Kjo ceremoni nderon heronjtë e Shqipërisë që sakrifkuan jetën për lirinë e vendit 79 vite më parë. Gëzuar Ditën e Çlirimit, Shqipëri”, thekson Ambasada e SHBA-së.

Shqiptarët kremtojnë sot 79-vjetorin e Çlirimit të Atdheut, njëkohësisht ditë kujtese e sakrificës sublime të mijëra të rinjve e të rejave që ranë heroikisht në emër të lirisë.

Prej 7 prillit të vitit 1939 e deri më 29 nëntor të vitit 1944, Shqipëria ishte e pushtuar, fillimisht nga Italia fashiste dhe pas kapitullimit të saj, në vjeshtë të vitit 1943, Shqipëria u pushtua nga forcat gjermane. Pas Çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor dhe pjesës kryesore të Shqipërisë së Veriut, qyteti i Shkodrës ishte i fundit që u çlirua. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shqiptarët u radhitën në krah të koalicionit antifashist dhe zhvilluan luftë çlirimtare.

Përvjetorët e Çlirimit shënohen me homazhe tek përmendorja “Nënë Shqipëri” pranë Varrezave të Dëshmorëve.

Antony Blinken uron Shqipërinë për 111-vjetorin e Pavarësisë: SHBA krenare që punon me ju si aleate dhe partnere të NATO-s

Sekretari Amerikan i Shtetit Antony Blinken ka uruar Shqipërinë për 111-vjetorin e Pavarësisë. Kreu i diplomacisë amerikane e konsideron Shqipërinë aleat dhe partner, teksa thekson se lidhja mes dy vendeve është e qëndrueshme. Përmes një deklarate për shtyp, ai ka thënë se SHBA është krenare që punon me Shqipërinë si aleate dhe partnere të NATO-s.

Blinken ka falenderuar vendin tonë për mirëpritjen dhe mbështetjen fuqishme integritimit dhe plotë në komunitetin euroatlantik dhe në rrugën drejt anëtarësimit BE.

Sipas sekretarit të Shtetit Amerikan, lidhjet midis kombeve tona, të bazuara në vlerat, kulturën dhe miqësinë e përbashkët mbeten të qëndrueshme.

Postimi i Plotë:

“Në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, uroj qeverinë dhe popullin e Shqipërisë për 111-vjetorin e Pavarësisë. Shtetet e Bashkuara janë krenare që punojnë me ju si aleatë dhe partnerë të NATO-s të angazhuar për të forcuar përpjekjet e Shqipërisë për Reformën në Drejtësi, për të çuar më tej bashkëpunimin tonë



për sigurinë kibernetike dhe për të vazhduar mbështetjen e palëkundur për Ukrainën përballë luftës së agresionit të Rusisë. Ju falenderojmë për mirëpritjen tuaj bujare të afganëve dhe mbështetjen fuqishme integritimit tuaj të plotë në komunitetin euroatlantik, veçanërisht përmes përparimit në reformat e sundimit të ligjit dhe drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Zgjedhja e fundit e Shqipërisë në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut është një shenjë respek-

ti ndërkombëtar për përparimin që ka bërë kombi juaj në dekadat e fundit dhe një njohje e shërbimit të tij shembullor në vitet 2015-2017. Ne jemi krenarë që shërbejmë përkrah Shqipërisë dhe presim me padurim të punojmë së bashku për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut në mbarë botën. Lidhja midis kombeve tona, e bazuara në vlera, kulturën dhe miqësinë e përbashkët mbeten të qëndrueshme. Puna jonë e përbashkët le të vazhdojë të përparojë”.



Samiti i III-të i Diasporës bën bashkë në Tiranë shqiptarët e të gjithë trevave



Samiti i Tretë i Diasporës, mbledhi në Tiranë shqiptarë nga çdo cep i botës. Nga politikanë, e deri në emigrantë me histori suksesi. Në këtë ditë bashkimi kryeministri Edi Rama propozoi shpalljen e ditës së Alfabetit, si festë kombëtare.

“Është e çuditshme por prapë e Arbën Xhaferrit i cili nuk jeton më, por pati vizionin të kërkojë që dita e alfabetit të jetë një ditë e njohur si festë kombëtare për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Tani mendoj se është koha që kjo të jetë një ditë feste kombëtare edhe në Shqipëri dhe patjetër unë besoj se edhe presidentja e Kosovës t’ja japë këtë sugjerim kryeministrit të vetë”, tha Rama.

Kryeministri Edi Rama tha gjatë fjalës së tij në samitin e tretë të Diasporës se 22 nëntori që njihet si

Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe që njihet si festë kombëtare në Maqedoninë e Veriut, të njihet si e tillë edhe në Shqipëri.

Ai i kërkoi presidentes Vjosa Osmani, që këtë t’ja propozonte edhe Albin Kurtit.

“Me një sugjerim shumë të arsyeshëm të presidentit, dua ta kornizoj këtë fjalë edhe në funksion të ftymës së këtij samiti por edhe në funksion të asaj që ka rëndësi të jemi bashkë të ndihmojmë njëri tjetrin. Është e çuditshme por prapë e Arbën Xhaferrit i cili nuk jeton më, por pati vizionin të kërkojë që dita e alfabetit të jetë një ditë e njohur si festë kombëtare për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Tani mendoj se është koha që kjo të jetë një ditë feste kombëtare edhe në Shqipëri dhe patjetër unë besoj se edhe presidentja e Kosovës t’ja japë këtë sugjerim kryeministrit

të vetë. Unë e dëgjoj presidentin për veten time”- u shpreh Rama.

Falënderues për kontributin e tyre, presidenti Bajram Begaj, kërkoi që diasporës t’i shlyhet borxhi për të drejtën e votës.

“Vota, duhet të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre pa ardhur në Shqipëri. Diaspora të ketë përfaqësim politik për t’u dhënë zë shqiptarëve jashtë vendit. Ju jemi borxhlinj. Në aspektin e remitancave, ideve dhe nismave të ndryshme”, tha Begaj.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka mbajtur fjalën e saj në samitin e tretë të Diasporës në Tiranë. Ajo tha se pavarësisht se shqiptarët janë shpërndarë anembanë globit, ata ruajnë vlerat dhe traditat e tyre.

Ndërsa duke folur për rolin e madh të Diasporës shqiptare, Vjosa Osmani nuk la pa përmendur edhe shqiptarët e Preshevës,

Medvegjës dhe Bujanovcit, duke thënë se ata të cilët banojnë në këto treva, po përballen me spastrim etnik nëpërmjet mjeteve administrative.

“Përderisa jemi mbledhur sot të gjithë këtu, mos të harrojmë se vëllezërit tonë në Medvegjë, Preshevë dhe Bujanovc ende po përballen me diskriminim etnik dhe përballen me spastrim etnik nëpërmjet mjeteve administrative. Sot iu them nga këtu: ju nuk jeni vetëm. Ne jemi me ju për mbrojtjen e të drejtave tuaja. Roli historik i mërgatës shqiptare është i jashtëzakonshëm. Përgjatë kohës sfiduese ata ishin përkrahës të vendosur të aspiratave tona kombëtare. Është shtylla për lëvizjen kombëtare për liri dhe pavarësi të shqiptarëve. Kanë qenë burim force për ne. Në vitet e 90-ta, mërgata jonë ishte zëri ynë në të gjitha qendrat e vendim-marrjes”- u shpreh Osmani.

Më tej, ajo dha edhe lajmin se shqiptarët e Kosovës të cilët kanë emigruar në vende të ndryshme, së shpejti do kenë mundësinë të votojnë në ambasadat dhe zyrat konsullore nga vendet ku jetojnë.

“Mërgata jonë do ta ketë të drejtën të votojë në ambasadat dhe konsullatat tona në vendet ku ata jetojnë”- shtoi presidentja e Kosovës.

Kosova e ka arritur votën e diasporës dhe gjithçka që kërkon është t'i qëndrohet pranë Preshevës që po përballen me spastrim etnik nëpërmjet mjeteve administrative. Të njëjtën thirrje pati edhe kreu i kësaj komune, Shqiprim Arifi.

“Po kalon një situatë të pabesueshme. Çdo qytetar mbytet ngadalë nëpërmjet një procesi të spastrimit etnik e burokratik. Kemi front të padukshëm me



Serbinë. Të jemi të unifikuar. Çdo ditë që humbim, është një humbje e një qytetari shqiptar në vend autokton. Investoni më shumë kohë”, u shpreh Arifi.

Në Samitin III të Diasporës fjalën e mori edhe Mark Gjonaj, një politikan shqiptaro-amerikan, i cili aktualisht mban postin e kryetarit të Këshillit Koordinues të Diasporës.

“Sot është një ditë e lumtur, sepse sot në SHBA festohet Thanksgiving, një ditë pushimi për të menduar për të mirat që kemi. Dhe unë sot ia di për nder Zotit, që jam këtu me ju, me shqiptarë

nga të gjitha anët e botës, për të diskutuar për një të ardhme më të mirë”, u shpreh Gjonaj, i cili e konsideroi Këshillin Koordinues të Diasporës si një urë lidhëse të diasporës me atdheun.

Një nga problemet e diasporës, sipas Gjonajt, është se shpesh konsiderohet si e Kosovës, por në fakt është e gjithë Shqipërisë dhe e gjithë shqiptarëve.

“Sot më shumë se kurrë kemi nevojë për bashkim, sepse kemi më shumë gjëra që na bashkojnë sesa na ndajnë. Ne jemi një. Është e vërtetë se kemi dy fe, por besojmë një Zot, kemi dy shtete por jemi një komb, si shqiponja që ka dy krerë, por ka një trup”, tha Mark Gjonaj.

Më tej ai u zotua se nga gjithë trojet shqiptare, s’do lëshojmë asnjë pëllëmbë. “Do ta ruajmë, do të luftojmë për tokat, kombin e popullin”, tha kreu i KKD.

Për kreun e Këshillit të Diasporës Mark Gjonaj, samiti i ardhshëm duhet mbajtur në Kosovë, ndërsa një thirrje e pati për Aleksandar Vuçiq.

Samiti i diasporës 4 në Kosovë, më pas në Mal të zi edhe në preshevë. Jepja votën e diasporës se e meriton, që të mos shtyhet procesi. Merrni ligjin e Kosovës të votohet në zgjedhjet e ardhshme. Shembuj: 1. U bë Kosova shtet i





pavarur. Serbisë një mesazh: Mos na ngacmo Kosovën e kosovarët ma. Të vazhdojnë jetën që meritojnë. 2.Fitorja e kombëtares”, tha ai.

Mark Gjona kërkoi nga liderët shqiptarë të dalin me një mesazh unifikues si dhe të bihet darkord që samitet e ardhshme të diasporës të organizohen me rotacion: në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Çamëri etj.

Në përfundim, nga pozita e kryetarit të Këshillit Koordinues të Diasporës, Mark Gjona ka kërkuar që diasporës t’i jepet e drejta e votës, që në këtë samit dhe të mos vonohet as edhe një ditë më shumë, në mënyrë që diaspora të votojë që në zgjedhjet e ardhshme.

Kryetari i BDI-së në Maqedoninë e Veriut Ali Ahmeti, iu shpreh falënderues kryeministrit Rama, i cili sipas tij e ka ngritur i vetëm zërin për shqiptarinë.

“Vendet tona mund t’i kemi shpejt në BE, Europa s’mund të jetë e qetë pa Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi e RMV. Një hap para anëtarësim-it, duhet edhe më fort ta ngresh zërin., Na ke në krah”, u shpreh Ahmeti.

Mesazhe pati edhe nga zv.kryeministri i Malit të zi dhe Dritan Abazoviç.



“Integrimi i shqiptarëve në Mal të zi Ska ardh rastësisht, por faktorizimi i shtetit amë në drejtimin e Ramës. Për herë të parë anëtarë i GJK është një shqiptar”, tha Nik Gjekoshaj.

Gjatë fjalës së tij në Samitin e Tretë të Diasporës në Tiranë, Dritan Abazoviç tha se Shqipëria ka bërë një transformim të madh shoqëror. Ai tha se sot vendi ynë mban fjalën para tërë botës dhe tregon se si do të krijohet një shoqëri perëndimore dhe moderne. Sakaq, Abazoviç theksoi se e shikon të ardhmen e politikës paqësore dhe në samitin e katërt që do të mbahet nuk do të ketë asnjë problem.

“Sfida më e madhe për ne është që të mundim vetveten dhe kur ke



besim gjithçka arrihet. Vetëm kujtoni si ka qene Shqipëria 20 vite më parë dhe si është tani. Nuk kam menduar se do të pëson-te një transformim kaq të madh shoqëror. Unë nuk do të flas vetëm si shoku dhe mik i kryeministrit, por do të them që sot Shqipëria mban fjalën para tërë botës dhe tregon se si do të krijohet një shoqëri perëndimore dhe moderne. Si qytetar, si shqiptar, si europian jam i gatshëm të ballafaqohem me të gjithë sepse ideja e kombit tonë është që të gjendemi së bashku në koncept, në ligj. Unë e shoh të ardhmen e politikës paqësore, qofshin sfidat që kemi dhe bashkëpunim në shumë fusha.

Jam i sigurt që ky samit i treti tregon një sfidë të madhe që një herë kishim probleme me veten, më pas me të tjetër dhe jam i bindur që kur të vij samiti i katërt nuk do të kemi probleme të tjera. Dje ka qene Dita e Arbëreshëve dhe ai popull ka treguar superioritetin dhe ruajtjen e kulturës së vetë, dhe ka dhënë një kontribut se si një kulturë e madhe italiane mburret me ta. Unë jam i sigurt që në BE ne të gjithë së bashku kemi për të krijuar një vlerë dhe një kontribut më të lartë që e presin kombin tonë në gjeneratat ndër vite”, tha Abazoviç.

CILI ËSHTË PLANI I NATO-S PËR BALLKANIN?



Kreu i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg sapo përfundoi vizitën në vendet e Ballkanit Perëndimor këtë javë. Çfarë po përipiqet të bëjë aleanca ushtarake para disa vatrave të pashuara të zjarrit aty? Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg këtë javë brenda pak ditësh vizitoi disa vende të Ballkanit Perëndimor për të treguar mbështetjen dhe angazhimin e aleancës veriore atlantike në një rajon që ka në disa fronte njëherësh disa vatra të pashuara zjarri që rrezikojnë sigurinë. “Ky rajon nga ana strategjike është i rëndësishëm për NATO-n, dhe ka disa arsye për shqetësime”, tha Stoltenberg në një konferencë shtypi në Shkup të mërkurën në fund të turit ballkanik. “Ne shohim kërcënim për shpëputje në Bosnje-Hercegovinë, një gjendje të brishtë të sigurisë në Kosovë, dhe një ngecje të normalizimit mes Beogradit dhe Prishtinës.”

Që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë në vitet 90-të, NATO ka luajtur një rol të rëndësishëm në stabilizimin e rajonit. Ajo intervenoi në Bosnje dhe Kosovë

në luftërat e përgjakshme që shënuan edhe fundin e Jugosllavisë dhe krijimin e shteteve të pavarura. Sot tre nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë në NATO. Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Serbia, Kosova dhe Bosnje-Hercegovina nuk janë pjesë e aleancës.

Zhvillimet në Kosovë, shqetësuese

Armiqësia mes minoritetit etnik serb dhe shumicës shqiptare në Kosovën e njohur vetëm nga 22 nga 27 vende të BE dhe SHBA është rritur. Serbia dhe Rusia e mohojnë pavarësinë e Kosovës. Në maj trupat e NATO-s u pla-



Jens Stoltenberg dhe DIMITAR KOVACEVSKI
Fotografi:
Government of North Macedonia

gosën në përpjekje për të ulur tensionet në veri të Kosovës, pranë kufirit serb. Serbët e Kosovës kanë një mosbesim të thellë ndaj autoriteteve të Kosovës dhe ruajnë marrëdhënie të ngushta me Serbinë. Më 24 shtator katër vetë u vranë në luftimet mes policisë së Kosovës dhe serbëve etnikë që u barrikaduan në një manastir.

Si rezultat NATO përforcoi trupat në Kosovë me 1000 ushtarë dhe patrullimet në veriun e dominuar nga serbët. Trupat e KFOR-it kështu arrijnë në 4.500 vetë, sipas agjencisë Reuters. Stoltenberg në Prishtinë tha të hënën, se NATO do të bëjë çfarë është e nevojshme të ruajë sigurinë, qetësinë dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit në Kosovë. “Ne tani jemi duke rishikuar, nëse duhet të kemi një rritje të përhershme që të sigurojmë se spiralja nuk del jashtë kontrollit dhe krijon një konflikt të rëri të dhunshëm në Kosovë apo më tej në rajon.”

Republika Srpska kërcënon të shpëputet nga Bosnja

Ndërkohë që në Bosnje-Hercegovinën multietnike, Republika

Srpska kërcënon të shkëputet. Kjo republikë përbën rreth gjysmën e territorit të Bosnje-Hercegovinës me rreth 1,2 milionë banorë, shumica serbë etnikë. Republika Srpska u krijua gjatë shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë në një kontekst të përgjakshëm. BE, e cila mori misionin paqeruatës në Bosnje-Hercegovinë nga NATO në vitin 2004 nuk është aspak popullore në Republikën Srpska, e cila mban lidhje të ngushta me Serbinë dhe Rusinë.

Mesazh për Moskën

Para këtyre krizave, në fund të turit të tij ballkanik në Shkup, Stoltenberg në një deklaratë me kërre të vendeve aleate të NATO-s. Shqipërisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut iu drejtua pjesërisht Mokës. NATO e shikon Rusinë të luajë një rol destabilizues, veçanërisht që nga fillimi i pushtimit të Ukrainës. “Shtete autoritare si Rusia kërkojnë të minojnë demokracitë tona me kërcënime kibernetike dhe hibride”, tha Stoltenberg që pritet të largohet si kreu i aleancës veriore atlantike.

Sipas Bojana Zoric nga Insituti European për Studimet e Sigurisë, në përgjithësi qëllimi i Rusisë në rajon është të ndalë shtrirjen e NATO-s dhe pëfshirjen e tyre në BE. Lufta në Ukrainë i ka bërë të qarta ndarjet ekszistuese. “Ballkani Perëndimor nuk është i unifikuar, kur vjen puna tek përgjigja që duhet dhënë për luftën në Ukrainë.” Kjo i shkon në favor Moskës, sipas Zoric. “Rusia gjithmonë dëshiron të kapë çdo mundësi për të prodhuar tensione dhe rindezë armiqësitë e vjetra në rajon dhe në një mënyrë të përdorë ndarjet etnike për përf-



Stoltenberg me Këshillin Ministror në Bosnje-Hercegovinë
Fotografi: Samir Jordamovic/Anadolu/picture alliance.

itimet e saj”, tha Zoric për DW.

Çfarë arriti Stoltenberg me vizitën në Ballkanin Perëndimor?

Për Zoric, vizita e kreu të NATO-s në Ballkan ishte më shumë për të dërguar një “mesazh të qartë në rajon dhe faktorë të tjerë prezentë, të përfshirë duke pasur parasysh edhe Rusinë, se NATO mbetet fuqimisht e angazhuar për të ruajtur sigurinë.”

“Një prezencë e shtuar e NATO-s do duhej të bëjë që të gjitha palët të tregojnë vetëpërmbytje me shpresë të nxisë edhe rigjallërimin e normalizimit efektiv të dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit.” Serbia, e cila dëshiron të jetë pjesë e BE, por jo e

NATO-s, nuk do të rrezikojë një konflikt me aleancën ushtarake, sipas Zoric. Shumica e vende të BE janë në NATO. Aktualisht Beogradi mban marrëdhënie të stabilizuara me NATO-, sipas analistes. Prandaj ekspertja nuk sheh rrezik akut konfrontimi në horizont. “Jo vetëm tani, por edhe në të ardhmen, Rusia nuk do të jetë e aftë t’ia dalë për t’i hyrë një lufte në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht duke pasur në mendje, se gjysma e Ballkanit Perëndimor është në NATO, thekson Zoric. Në vend të kësaj Moska do të tentojë më shumë të vazhdojë me politikën e saj të nxitjes së tensioneve duke punuar për këtë me partnerët që ka në rajon. /dw



Stoltenberg pritet në Prishtinë nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani
Fotografi: Office of the Kosovo Presidency

Vlerësime e kritika për Samitin III të Diasporës!

Nga ALBAN DACI

Samiti është kthyer padyshim një traditë mjaft e rëndësishme, sepse ka një simbolikë dhe një motivim të rëndësishëm që nxit shumë shqiptarë që jetojnë jashtë të kthehen në Shqipëri, të takohen e të njihen me njëri-tjetrin, të kenë mundësi të kenë kontakte me institucionet!

Po ashtu Samiti i Diasporës është bërë një simbolikë për të bashkuar të paktën në një ditë të vetme faktorin politik shqiptar në Ballkan, duke lënë për pak çaste ndasit. Kështu ndodhi edhe në këtë Samit III ku të gjithë liderat shqiptarë që janë në pushteti në Ballkan u takuan, mbajtën fjalimet e tyre duke vlerësuar kontributin e Diasporës. Sigurishtë në këtë histori në pozicionin më komod ishte Presidentja e Kosovës e cila ka krijuar tashmë një traditë të mirë e të shëndoshë demokratike duke tejkaluara pa problem barrierën e votës së emigrantëve që votojnë tashmë në vendet ku jetojnë!

Normal një eksperiencë duhet të jetë një proces që falë eksperiencës duhet të jetë në përmissim të vazhdueshëm, por kjo nuk po ndodh me traditën e Samitit të Diasporës! Nga një projekt i mirëfilltë i politikave shtetërore në shërbim të shqiptarëve që jetojnë jashtë po kthehet vetëm në një mundësi shumë të mirë që



pushteti të bëj propagandë! Një zhgënjim këtë herë sipas meje ishin panelet e ndryshme që ishin organizuara! Seleksionimi duhet të ishte bërë mbi bazën e CV dhe kriterëve dhe jo përmes garës që kush ulët në vendin e parë! Për shëmbull në panelin e Politikës të Jashtme pashë njerëz që s'kanë lidhje me këtë dhe kanë një arsimim nën nivelin inferior! Në fakt panelet duhet të ishin një forum serioz për të diskutuar palët, por në fakt përfaqësuesit e Diasporës, që ishin me pakicë e me shumicë ishin përfaqësuesit e administratës të ministrisë që e organizonte dhe e drejtonte!

Gjithashtu ato pak përfaqësues të Diasporës ishin përballë panelit të pushtetit e mund të dëgjonin fjalimet e këtyre të fundit pa pasur mundësi serioz për të shpalosur ide, projekte, ngritur shqetësime! Pra, dukej sikur emigrantët kishin bërë qindra apo

mijëra klm për të dëgjuar të arrijtjet e Qeverisë.

Një zhgënjim tjetër mjaft i rëndësishëm për shqiptarët që jetojnë jashtë ishte fakti se Qeveria shqiptare, ose Partia Socialiste si partia më e madhe në vend nuk doli me asnjë qëndrim në lidhje me të drejtën e votës në votimet e përgjithshme të 2025! Ajo që vëzhgohet në këto takime është niveli shumë i ulët i administratës publike që punojnë nëpër institucione shqiptarë që nuk pasqyrojnë as gjysmën e nivelit të shqiptarëve që jetojnë jashtë për t'i mos krahasuar me ata që janë shkolluara jashtë!

Gjithashtu, në shumë raste deri në neveri është servilizmin ose gara për servilizëm të shqiptarëve që jetojnë jashtë përballë pushtetit! Megjithatë, kjo është një sëmundje e vjetër e shoqërisë tonë! Shpresoj që Samiti i tjetër të jetë ndryshe nga ku që ishte sot!

PANAIRI I VERËS TË “OPEN BALKAN”

Vuçiq zëvendëson Kryeministrin Rama

Presidenti i Republikës së Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duket se ka gjetur një partner të ri për Ballkanin e Hapur, pas daljes nga nisma të kryeministrit shqiptar Edi Rama.

Në panairin e dytë të verës në kuadër të “Open Balkan”, mori pjesë presidenti i Malit të Zi, Jakov Milatoviç dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski.

Duket se kryeministri Rama është zëvendësuar nga presidenti i ri malazez.

Presidenti Vuçiq, në një bisedë me Milatoviç, para ceremonisë së hapjes së panairit, tha se në panair janë të pranishëm rreth 40 ekspozues nga Mali i Zi, që është një numër i madh për një vend të përmasave të tilla.

“Jam krenar për verërat serbe, të cilat po përparojnë më shpejt. Verërat malazeze po përparojnë mirë gjithashtu”, tha presidenti Vuçiq, duke shtuar se kur vjen puna ndaj verërave, nuk mund të mashtrosh askënd.

“Mund të mashtroshi në tregun e makinave, por jo në tregun e verërave”, tha presidenti Vuçiq. Milatoviç ka thënë se nuk pajtohet me presidentin e Serbisë për të gjitha çështjet, por sigurisht që pajtohen për verën.

“Kam ardhur me ftesë të Presidentit të Serbisë. Vera na bashkon pa marrë parasysh disa dallime të vogla. Unë e përgëzoj Vuçiqin për një ide të madhe dhe një organizim të mirë dhe nëse ndonjë integrim rajonal do të



quhet Oper ballkan apo Procesi i Berlinit është më pak i rëndësishëm, e rëndësishme është bashkëpunimi dhe ky është mesazhi më i rëndësishëm”, theksoi Milatoviç.

Presidenti Vuçiq theksoi se në Berlin nuk u pëlqen ajo që nuk mund ta menaxhojnë dhe se, përkundër kësaj, atij i pëlqen shumë menaxhimi përmes “Open Ballkan”.

“Përmes iniciativës Open Balkan,



ne kemi rezultate të dukshme që mund të shihen përmes numrave. Shkëmbimi tregtar midis Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Serbisë është rritur me 25 për qind. Ka kaluar një miliard euro, që është shkëmbimi tregtar më i madh në 18 vitet e fundit midis dy vendeve”- tha presidenti Vuçiq.

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, një nga bashkëkrijuesit e “Open Balkan” e konsideroi të mbyllur këtë iniciativë me rikthimin e Procesit të Berlinit pak kohë më parë. Edhe pse mungoi fizikisht Rama e pati një video-mesazh në nisje të panairit.

Pas një dite të gjatë Presidenti Vuçiq shijoi darkën me Presidentin e Malit të Zi, Jakov Milatoviç dhe kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski. Në rrjete sociale Presidenti Vuçiq ka ndarë një pjesë të atmosferës me mbishkrimin: “Rroftë miqësia mes Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë!”.

KE prezanton një plan të ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë 6 miliardë euro grante dhe kredi

Komisioni Evropian miratoi një Plan të ri Rritjeje për Ballkanin Perëndimor, me synimin për të sjellë disa nga përfitimet e anëtarësimit në rajon përpara anëtarësimit, për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të përshpejtuar konvergencën socio-ekonomike aq të nevojshme. Objektivi duhet të jetë t'u mundësojë partnerëve të rrisin reformat dhe investimet për të përshpejtuar ndjeshëm shpejtësinë e procesit të zgjerimit dhe rritjen e ekonomive të tyre. Për këtë, për periudhën 2024-2027 është propozuar një pakete e re e Reformës dhe Rritjes prej 6 miliardë eurosh për Ballkanin Perëndimor. Pagesat do të bëhen vetëm pas përmbushjes së reformave të dakorduara.

Plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor bazohet në katër shtylla, që synojnë:

1-Rritja e integritimit ekonomik me tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian, me kusht që Ballkani Perëndimor të përafrohet me rregullat e tregut të vetëm dhe të hapë sektorët dhe zonat përkatëse për të gjithë fqinjët e tyre në të njëjtën kohë, në përputhje me Tregun e Përbashkët Rajonal. Sugjerohen shtatë veprime prioritare:

- Lëvizja e lirë e mallrave;
- Lëvizja e lirë e shërbimeve dhe punëtorëve;
- Qasja në zonën e vetme të pagesave në euro (SEPA);
- Lehtësimi i transportit rrugor;



-Integrimi dhe dekarbonizimi i tregjeve të Energjisë;

-Tregu i vetëm dixhital;

-Integrimi në zinxhirët e furnizimit industrial

Nxitja e integritimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Tregut të Përbashkët Rajonal, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, të cilat potencialisht mund të shtojnë 10% në ekonomitë e tyre;

Përshpejtimi i reformave themelore, duke përfshirë grupin themelor, mbështetjen e rrugës së Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, përmirësimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal;

Rritja e asistencës financiare për të mbështetur reformat përmes një Lehtësie për Reforma dhe Rritjeje për Ballkanin Perëndimor për periudhën 2024-2027, një

propozim për një instrument të ri me vlerë 6 miliardë euro, i përbërë nga 2 miliardë euro grante dhe 4 miliardë euro kredi koncesionare, me pagesë të kushtëzuar që partnerët e Ballkanit Perëndimor të përmbushin reforma specifike socio-ekonomike dhe themelore. Si pjesë e Planit të Rritjes, çdo partner i Ballkanit Perëndimor do të ftohet të përgatisë një Agjendë Reformash bazuar në rekomandimet ekzistuese, duke përfshirë nga Paketa vjetore e Zgjerimit dhe Programet e Reformës Ekonomike të vendeve (ERP). Kjo Agjendë Reforme do të konsultohet, vlerësohet dhe miratohet nga Komisioni.

Ursula von der Leyen, Presidente e Komisionit Evropian tha se plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor është një ofertë e rëndësishme për partnerët tanë, duke ofruar një nxitje për arritjen e progresit në reformat përkatëse

themelore dhe socio-ekonomike. Kjo ofertë gjithashtu mund të përshpejtojë progresin në rrugën e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes Dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Secili prej partnerëve tanë në Ballkanin Perëndimor ka një mundësi për të nxitur rritjen ekonomike dhe përfundimisht për të fituar akses në Tregun e Vetëm Evropian edhe përpara zgjerimit. Kjo është edhe në interes të BE-së në tërësi

Ndërsa Përfaqësuesi i Lartë/Zëvendëspresidenti Josep Borrell theksoi se: “Plani i ri i Rritjes së

Ballkanit Perëndimor dhe Lehtësia e re e Reformës dhe Rritjes bazohen në Planin Ekonomik dhe Investues (PIE) prej 30 miliardë eurosh, i nisur me sukses në vitin 2020. Plani ynë i ri i rritjes prej 6 miliardë eurosh është një katalizator unik për të përshpejtuar gjendjen reale socio-ekonomike integrimin në rajon. Ndërsa përshpejtojmë zbatimin e reformave themelore, ne do të hapim tregun tonë të vetëm për Ballkanin Perëndimor. Kjo do të zvogëlojë ndarjen ekonomike midis Bashkimit Evropian dhe partnerëve tanë dhe do t'i përgatisë

ata për konkurrencën në tregun e vetëm të BE-së, në mënyrë që ata të mund të korrin përfitimet e anëtarësimit të tyre në BE që në momentin e parë.”

“Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor është instrumenti ynë për të nxitur rajonin – për të përshpejtuar integrimin real në terren. Ne ndihmojmë gjatë gjithë rrugëtimit për të përshpejtuar zbatimin e reformave në mënyrë që vendet e rajonit të fillojnë të jenë pjesë e Tregut Unik të BE-së – bazuar në 4 liritë – ndërkohë që reformat përparojnë”, tha Oliver Varhelyi.

Kosovë-Shqipëri-Maqedoni e Veriut, Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim drejt integritimit evropian

Një delegacion i përbashkët me anëtarë nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Komisioni për Çështjet Europiane, udhëhequr nga kryetaret Mimi Kodheli dhe Jorida Tabaku, morën pjesë në takim trilateral Kosovë-Shqipëri-Maqedoni e Veriut mbajtur sot në Kuvendin e Kosovës.

Takimi iniciuar nga Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Diasporë i Kosovës pati si temë kryesore bashkëpunimin rajonal, perspektivën europiane të rajonit tonë si dhe shkëmbimin e eksperiencave të ndërsjellta në këtë drejtim.

Në ndërhyrjet e tyre kryetaret Kodheli dhe Tabaku vlerësuan rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe të vepruarit si një grup i vetëm. Për kryetaren Kodheli e rëndësishme mbetet ndarja e informacionit, si dhe shkëmbimet e herëpashershme me fqinjët.

Nga ana tjetër kryetarja Tabaku



duke e cilësuar procesin e integritimit çështje strategjike por tashmë me zhvillimet e fundit ne arenën ndërkombëtare është edhe një çështje sigurie, theksoi se duhet të shfrytëzojmë procesin e integritimit për transformimin e vendeve tona. Ajo nënvizoi rëndësinë e përafrimit të legjislacionit dhe po ashtu shpejtësinë më të cilën realizohet ky proces.

Në përfundim të takimit u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunimin drejt integritimit evropian, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe harmo-

nizimin me vlerat euroatlantike ndërmjet Komisioneve për Punë të Jashtme dhe Integrim Evropian të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Në takim morën pjesë deputetët Lavdrim Krrashi, Bardhyl Kollçaku si dhe Ilirjan Pendavjini ndërsa kishte përfaqësues edhe nga Kuvendi i Bosnjë-Hercëgovinës si dhe Kroacia.

Gjatë vizitës në Prishtinë delegacioni nga Kuvendi u prit në takim nga Besnik Bislimi, Zëvendëskryeministër i Parë si dhe u zhvilluan takime të tjera.

Udhëheqësit arabë dhe myslimanë bëjnë thirrje për përfundimin e menjëhershëm të luftës në Gaza



Arabia Saudite dhe vendet e tjera muslimane bënë thirrje të shtunën për përfundimin e menjëhershëm të operacioneve ushtarake në Gaza, duke hedhur poshtë justifikimin e Izraelit për veprimet e tij kundër palestinezëve si vetëmbrojtje.

Samiti i jashtëzakonshëm i përbashkët islamik-arab në Riad i kërkoi Gjykatës Ndërkombëtare Penale të hetojë “krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që Izraeli po kryen” në territoret palestineze, sipas një komunikate përfundimtare.

Arabia Saudite ka kërkuar të bëjë presion mbi Shtetet e Bashkuara dhe Izraelin për t'i dhënë fund armiqësive në Gaza dhe Princi i Kurorës Mohammed bin Salman, sundimtari de facto i mbretërisë, mblodhi liderët arabë dhe myslimanë për të përforcuar atë mesazh.

Dhjetra liderë duke përfshirë presidentin iranian Ebrahim Raisi, presidentin turk Tajip Erdogan, emirin e Katarit Sheikh Tamim

bin Hamad Al Thani dhe presidentin sirian Bashar al-Assad, i cili u mirëprit përsëri në Ligën Arabe këtë vit, morën pjesë.

Princi i kurorës Mohammed pohoi “dënimin dhe refuzimin



Princi i kurorës
Mohammed

Ne po përballemi me një katastrofë humanitare që dëshmon dështimin e Këshillit të Sigurimit dhe komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund shkeljeve flagrante izraelite të ligjeve ndërkombëtare,

kategorik të kësaj lufte barbare kundër vëllezërve tanë në Palestinë”.

“Ne po përballemi me një katastrofë humanitare që dëshmon dështimin e Këshillit të Sigurimit dhe komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund shkeljeve flagrante izraelite të ligjeve ndërkombëtare,” tha ai në një fjalim në samit.

Presidenti palestinez Mahmoud Abbas tha se palestinezët po përballëshin me një “luftë gjenocidale” dhe u kërkoi Shteteve të Bashkuara t'i japin fund “agresionit” izraelit.

Raisi përshëndeti grupin militant islamik palestinez Hamas për luftën kundër Izraelit dhe u kërkoi vendeve islamike të vendosin sanksione ndaj naftës dhe mallrave ndaj Izraelit.

“Nuk ka rrugë tjetër veçse t'i rezistosh Izraelit. Ne puthim duart e Hamasit për rezistencën e tij kundër Izraelit”, tha zoti Raisi në fjalimin e tij.

Lindja e Mesme ka qenë në rrezik



që kur luftëtarët e Hamasit u tërbuan në Izrael më 7 tetor, duke vrarë 1200 njerëz.

Që atëherë, Izraeli ka përshkallëzuar sulmin e tij në Gaza, ku 11,078 njerëz ishin vrarë që nga e premtdja, 40 për qind e tyre femijë, sipas zyrtarëve palestinezë.

Lufta ka përmbysur aleancat tradicionale të Lindjes së Mesme pasi Riadi është angazhuar më ngushtë me Iranin, është tërhequr kundër presionit të SHBA për të dënuar Hamasin dhe ka pezulluar planet e tij për të normalizuar lidhjet me Izraelin.

